



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

1448
Nr. Prot

Vlorë më 24.09.2024

VENDIM

Nr. 16 datë 23.09.2024

“PËR MIRATIMIN E AKTIVITEVE KULTURORE ” NË KËSHILLIN E QARKUT
VLORË

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”; Ligjit 9408, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar; Ligjit “Për buxhetin e vitit 2024” VKQ nr.16 datë 27.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2024”; VKQ nr.2 datë 26.03.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e Këshillit të Qarkut të vitit 2024, miratuar me VKQ nr. 16 datë 27.12.2023”; VKQ nr.8 datë 26.03.2024 “Për miratimin e dokumentit strategjik “Vlora 2030” miratuar në përputhje me nevojat dhe synimet e përgjithshme për zhvillimin dhe përmirësimin e territorit të Qarkut të Vlorës, duke përfshirë edhe aspektet e zhvillimit ekonomik, kulturor, turizmit dhe agroturizmit.

VENDOS:

1. Të miratohet aktiviteti Festivali “*Meloditë Qytetare*” me ndryshime financiare në buxhet sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Të miratohet aktiviteti “*Verë dhe Traditë*” si pjesë e projektit për promovimin e qarkut pa ndryshime financiare në buxhet.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata e Këshillit të Qarkut .
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas pikës 3, neni 78 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. 877/Prot, datë 25.09.2024

Adresa Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +35533421608



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Relacion Festivali “Meloditë Qytetare”

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore “ i ndryshuar; Ligjin nr.93/2015 “Për turizmin”; Ligjit 9408, datë 07.04.2003 “Për trashëgiminë kulturore” i ndryshuar; Ligjit “Për buxhetin e vitit 2024” Vendimit të Këshillit të Qarkut nr.16 datë 27.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2024” ; Vendimit të Këshillit të Qarkut nr.8 datë 26.03.2024 “Për miratimin e dokumentit strategjik “Vlora 2030” miratuar Në përputhje me nevojat dhe synimet e përgjithshme për zhvillimin dhe përmirësimin e territorit të Qarkut të Vlorës, duke përfshirë edhe aspektet e zhvillimit ekonomik, kulturor, turizmit dhe agroturizmit.

Përse është përzgjedhur ky projekt?

Në vitet e fundit, zhanri artistik që përfaqëson traditën dhe folkun e zonës së Qarkut të Vlorës ka pësuar një zbehje të ndjeshme, duke u bërë më i vështirë për të ruajtur dhe transmetuar këto vlera tek brezi i ri. Ky projekt bazuar në Planin Strategjik, u mendua të zhvillohet për të ndihmuar në ringjalljen dhe promovimin e këtyre vlerave kulturore përmes organizimit të një festivali që do të evidentojë gjendjen aktuale të bartësve të këtij zhanri dhe do të shqyrtojë sa këto vlera janë transmetuar në brezat e rinj.

Qarku i Vlorës ka një histori të pasur në këtë zhanër, përfshirë grupe të njohura si Sazet e Vlorës, Delvinës, Konispolit dhe Finiqit. Kënga qytetare e kësaj zone, e njohur për autenticitetin e saj dhe ndikimin minimal nga fqinjët, ka qenë e shquar për kontributet e artistëve si Th. Mone, R. Osmani, H. Dalipi dhe N. Papa. Ky projekt synon të rikthejë në vëmendje këto vlera dhe të krijojë një mundësi për ruajtjen dhe zhvillimin e tyre në të ardhmen.

Zhanri i këngës qytetare dhe sazëve nga Qarku i Vlorës përfaqëson një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë kulturore shqiptare dhe të gjithë qarkut . Këto forma artistike kanë një histori të pasur dhe unike që duhet ruajtur dhe promovuar. Realizimi i këtij projekti do të ndihmojë në përcjelljen e këtyre vlerave kulturore tek brezat e rinj, duke krijuar një ndjenjë të identitetit dhe krenarisë kulturore që është e rëndësishme për ruajtjen e diversitetit kulturor në vend.

Organizimi i këtij koncerti do të rrisë ndërgjegjësimin dhe do të zgjojë vëmendjen mbi rëndësinë e traditës muzikore të Qarkut të Vlorës në mbështetje të ruajtjes së kësaj trashëgimie kulturore. Aktivitetet kulturore si ky festival do të kontribuojnë në forcimin e lidhjeve brenda komunitetit duke patur dhe një impakt konkret në turizmin kulturor.

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +35533421608



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORE

Angazhimi i artistëve të rinj dhe promovimi i tyre është një mënyrë efektive për të inkurajuar brezin e ri të marrë pjesë në ruajtjen dhe zhvillimin e traditave kulturore.

Ky projekt do të ofrojë mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve kulturore dhe artistike të këtij zhanri për të rikthyer edhe njëher këto tradita.

Organizimi i një festivali të tillë të përvitshëm, do të rrisë profilin e Qarkut të Vlorës si një qendër e rëndësishme kulturore, duke tërhequr vëmendjen e medias dhe turistëve. Ky profil do të ndihmojë në promovimin e turizmit dhe zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të rajonit.

Festivali do të ofrojë një mundësi për të vlerësuar dhe ndihmuar në përmirësimin e performancave artistike të grupeve dhe individëve që përfaqësojnë këtë zhanër dhe do të ndihmojë në zhvillimin e tyre profesional.

Krijimi i një ngjarjeje të suksesshme dhe të mirë organizuar do të ndihmojë në vendosjen e standardeve të larta për organizimin e aktiviteteve kulturore, duke siguruar që performancat dhe organizimi të jenë në përputhje me pritshmëritë e publikut dhe ekspertëve. Zbatimi i tij do të sjellë përfitime të konsiderueshme në ruajtjen e vlerave artistike dhe zhvillimin e mëtejshëm të aktiviteteve të tjera kulturore në rajon.

Fazat e Projektit

1. Faza e Parë: Evidentimi i Grupeve

Përmbajtja:

- **Evidentimi i Grupeve:** Kontaktimi dhe informimi i grupeve të interesuara për pjesëmarrje në koncert. Kjo përfshin ndarjen e kriterëve dhe përgatitjen e grupeve për ndjekjen e tyre.

2. Faza e Dytë: Vlerësimi dhe Përgatitja e Grupeve

Qëllimi: Të sigurohet që të gjitha grupet janë në përputhje me kriteret dhe të jenë të gatshme për performancën.

Përmbajtja:

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria", Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +3553421608



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

- **Kontakti me Grupet:** Vizita e grupeve për të parë performancat e tyre dhe për të diskutuar kriteret e koncertit.
- **Pjesëmarrja në Prova:** Vlerësimi i gjendjes artistike dhe përgatitja e grupeve për performancën. Kjo përfshin vlerësimin e kostumeve popullore dhe elementëve të tjerë të rëndësishëm për koncertin.
- **Vlerësimi i Kriterëve:** Kontrollimi i përmbushjes së kriterëve të përcaktuara si numri i instrumentistëve dhe këngëtarëve, dhe problemet që mund të hasen.

3.Faza e Tretë: Realizimi i Koncertit

Përmbajtja:

Qëllimi: Të realizohet një koncert i suksesshëm dhe i mirëorganizuar që do të promovojë vlerat kulturore dhe do të angazhojë komunitetin në ruajtjen dhe përcimin e këtij aktiviteti.

- **Organizimi i Koncertit:** Përgatitja e të gjitha aspekteve të koncertit, duke përfshirë infrastrukturën si ndriçimi, sistemi i zërit, screen-et, dhe stafi teknik.
- **Kontakti me Media:** Aranzhimi i bashkëpunimeve me TV shtetëror dhe media për filmin dhe transmetimin e koncertit.
- **Përgatitja e Skenarit:** Shkrimi i skenarit dhe organizimi i renditjes së grupeve në koncert për të siguruar një përvojë artistike dhe emocionuese për publikun.
- **Koordinimi i Elementëve Logjistikë:** Sigurimi i të gjitha detajeve teknike dhe organizative, përfshirë punën me konferencierët dhe ekipin teknik.

Për sa më sipër kërkojmë miratimin tuaj për zhvillimin e festivalit "Meloditë Qytetare" me qëllim ruajtjen dhe përcimin e vlerave kulturore jo materiale që mbart ky aktivitet, me efekt financiar në buxhet prej 2 500 000 Lekë.

Konceptoi:

Ilda Lama

Specialist për Arsimit, Kulturën, Turizmin, Çështjet Sociale dhe Zhvillimin e Projekteve

Miratoi:

Anisa Hyseni

Përgjegjës Sektorit Financ/Buxhet/Shërbime



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLORË

Relacion për aktivitetin “Verë dhe Traditë”

Të nderuar këshilltarë!

Bazuar në parashikimin Projekt Buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë për vitin 2024-2025: Në ligjin 139/2015 “Per vetqeverisjen vendore” i ndryshuar si dhe në degën 7 të Planin Strategjik “Vlora 2030” të miratuar me vendim të Këshillit të Qarkut Nr.8 datë 26.03.2023.

Këshilli i Qarkut Vlorë parashikon të organizojë në kuadër të projektit “Qarku Vlorë midis malit dhe detit” për promovimin e qarkut një aktivitet kushtuar gastronomisë ku në qëndër do të jetë Vera si një ndër produktet që po zhvillohet cdo ditë e më shumë në Qarkun e Vlorës. Ky aktivitet do të shfaq kulturën, traditën në kultivimin e vreshtave dhe përpunimit të verës. Është menduar që ky aktivitet të zhvillohet në muajin nëntor pasi ka mbaruar sezoni i vjeljes së rrushit dhe është fillimi i procesit të përpunimit të tij.

Ky aktivitet synon të sjellë në pah kulturën dhe traditën e vreshtarisë së Qarkut të Vlorës, duke promovuar gjithashtu agroturizmin dhe industrinë lokale.

Objektivat e Aktivitetit:

1. Promovimi i Vreshtarisë dhe Gastronomisë Lokale: Aktiviteti do të organizohet në muajin nëntor, për të përruruar sezonin e vjeljes së rrushit dhe të përpunimit të verës. Pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të njihen me kantinat me prodhimet dhe nënproduktet e tyre të cilat ofrohen në Qarkun e Vlorës.
2. Evidentimi i Traditave dhe Kulturës Lokale: Përmes një paneli degustimi verërash dhe një mini panairi me produkte lokale, aktiviteti synon të promovojë traditën dhe kulturën e vreshtarisë dhe gastronomisë së Qarkut të Vlorës.
3. Krijimi i Tregjeve dhe Ura të Reja Bashkëpunimi: Ky aktivitet të krijojë tregje të reja dhe të promovojë bashkëpunimin mes fermerëve, prodhuesve dhe konsumatorëve. Kjo do të ndihmojë në nxitjen e një ekonomie më të qëndrueshme dhe më të fortë për komunitetin lokal të Qarkut të Vlorës.

Struktura dhe Detaje të Aktivitetit:

Dita 1:

- Organizimi i një paneli degustimi verërash me produkte të prodhuara brenda Qarkut të Vlorës.
- Pjesëmarrësit do të prezantojnë produktet e tyre në stenda të organizuara për këtë qëllim.
- Koncert me muzikë lokale për të rritur atmosferën festive dhe për të shoqëruar pjesëmarrësit gjatë aktivitetit.
- Mini panair me produkte lokale, ku pjesëmarrësit do të kenë mundësinë të shijojnë dhe të blejnë produktet e vreshtarisë dhe gastronomisë së Qarkut të Vlorës.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

- Degustim i produkteve në stendat e organizuara për të prezantuar gamën e gjerë të produkteve lokale.

Ky aktivitet synon të krijojë një platformë për promovimin e vreshtarisë dhe gastronomisë lokale, si dhe për të thelluar lidhjet ndërmjet prodhuesve dhe konsumatorëve në Qarkun e Vlorës.

Ky aktivitet mendohet të ketë një kosto prej *1 000 000 Lekë*.

Kërkohej për sa më sipër miratimi për realizimin e këtij aktiviteti me qëllim përmbushjen e objektivave të Planit Strategjik "Vlora 2030" për zhvillimin ekonomik të rajonit.

Konceptoi:

Ilda Lamaj

Specialist për Arsimit, Kulturën, Turizmin, Çështjet Sociale dhe Zhvillimin e Projekteve

Miratoi:

Anisa Hyseni

Përgjegjës Sektorit Financ/Buxhet/Shërbime